



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria –Vlada-Government

Zyra e Kryeministrit-UredPremijera-Office of the Prime Minister

Zyra për Qeverisje të Mirë/Kancelarijaza Dobro Upravljanje/Office on Good Governance

RAPORT

PËR MBËSHTETJEN FINANCIARE PUBLIKE PËR OJQ-TË NË

KUADËR TË INSTITUCIONEVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

PËR VITIN 2024

Maj 2025, Prishtinë

TABELA E PËRMBAJTJES

LISTA E SHKURTESAVE	3
1. HYRJE	5
1.1 Metodologjia e përdorur	6
2. TË DHËNA E PËRGJITHSHME PËR RAPORTIM NGA ANA E ORGANIZATAVE BUXHETORE	8
2.1 Raportimi nga Organizatat Buxhetore.....	8
2.2 Të dhëna mbi financim publik të OJQ-ve të raportuara sipas institucioneve/organizatave buxhetore për vitin 2024.....	11
3. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR MBËSHTETJEN FINANCIARE PUBLIKE PËR OJQ-TË NË NIVEL TË MINISTRIVE, KOMUNAVE DHE ZYRËS SË KRYEMINISTRIT PËR 2024.....	11
4. TË DHËNA PËR MBËSHTETJEN FINANCIARE PUBLIKE PËR OJQ-TË SIPAS ZKM, MINISTRIVE DHE KOMUNAVE.....	24
4.1 Të dhënat e përgjithshme për financimin publik të OJQ-ve për vitin 2024 sipas raportimit nga ZKM dhe Ministrinë	24
4.2 Mbështetja Financiare për OJQ-të në kuadër të ZKM dhe MINISTRIVE për vitin 2024 krahasur me vitin 2023	26
4.3. Mbështetja në kuadër të ZKM dhe Ministrive.....	29
4.4. Mbështetja në kuadër të KOMUNAVE.....	30
5. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME.....	32
7.1 ANEKSE:LISTA E OJQ-ve PËRFITUESE DHE SHUMA E MBËSHTETJES FINANCIARE PUBLIKE PËR VITIN 2024 RAPORUAR SIPAS ZKM DHE MINISTRIVE TE LINJES NE PLATFORMEN PER FINANCIM.....	37
7.2 ANEKSE: LISTA E OJQ-ve PËRFITUESE DHE SHUMA E MBËSHTETJES FINANCIARE PUBLIKE PËR VITIN 2024 RAPORUAR SIPAS KOMUNAVE NE PLATFORMEN PER FINANCIM.....	37
7.3.LISTA E OJQ-VE PËRFITUESE NGA MBËSHTETJA FINANCIARE PUBLIKE NGA DONATORET PËR VITIN 2024	37
7.1 LISTA E OJQ-ve PËRFITUESE DHE SHUMA E MBËSHTETJES FINANCIARE PUBLIKE PËR VITIN 2023 RAPORUAR SIPAS ZKM DHE MINISTRIVE TË LINJES NË PLATFORMEN PËR FINANCIM.....	38
7.2.LISTA E OJQ-ve PËRFITUESE DHE SHUMA E MBËSHTETJES FINANCIARE PUBLIKE PËR VITIN 2023 RAPORUAR SIPAS KOMUNAVE NË PLATFORMEN PËR FINANCIM	Error! Bookmark not defined.
7.3.LISTA E OJQ-VE PËRFITUESE NGA DONATORET PËR VITIN 2024	76

LISTA E SHKURTESAVE

- | | |
|-----------|---|
| 1. ZKM | ZYRA E KRYEMINISTRIT |
| 2. MPB | MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME |
| 3. MAPL | MINISTRIA E ADMINISTRIMIT TË PUSHTETIT LOKAL |
| 4. MASHTI | MINISTRIA E ARSIMIT SHKENCËS TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT |
| 5. MBPZHR | MINISTRIA E BUJQËSISË PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL |
| 6. MD | MINISTRIA E DREJTËSISË |
| 7. MFPT | MINISTRIA E FINANCAVE, PUNËS DHE TRANSFEREVE |
| 8. MM | MINISTRIA E MBROJTJES |
| 9. ME | MINISTRIA E EKONOMISË |
| 10. MKK | MINISTRIA PËR KOMUNITETE DHE KTHIM |
| 11. MKRS | MINISTRIA E KULTURËS RINISË DHE SPORTIT |
| 12. MMPH | MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR |
| 13. MPJD | MINISTRIA E PUNËVE TË JASHTME DHE DIASPORËS |
| 14. MSH | MINISTRIA E SHËNDETËSISË |
| 15. MINT | MINISTRIA E INDUSTRIISË NDËRMARRËSISË DHE TREGTISË |
| 16. MZHR | MINISTRIA E ZHVILLIMIT RAJONAL |
| 17. OJQ | ORGANIZATA JO-QEVERITARE |

Fjalë hyrëse

Të nderuar/a

Publikimi i Raportit Vjetor mbi Mbështetjen Financiare Publike për Organizatat Joqeveritare për vitin 2024 përfaqëson një arritje të rëndësishme institucionale në Republikën e Kosovës. Gjatë vitit 2024, përveç publikimit të këtij raporti, kemi shënuar përparim të konsiderueshëm në ndërtimin e kapaciteteve institucionale, veçanërisht në fushat e planifikimit, publikimit të thirrjeve për financim, raportimit dhe administrimit të platformës për financimin publik të OJQ-ve. Çdo institucion përfaqësues ka kontribuar në mënyrë aktive në forcimin e këtyre proceseve, duke përfshirë ngritjen e kapaciteteve të koordinatorëve për raportim, ndërtimin e një sistemi të qëndrueshëm raportimi dhe avancimin e mëtejshëm të platformës online.

Këto zhvillime pasqyrojnë përkushtimin tonë të vazhdueshëm për rritjen e transparencës, llogaridhënies dhe efikasitetit në ndarjen dhe përdorimin e fondeve publike në mbështetje të shoqërisë civile.

Raporti ofron një pasqyrë gjithëpërfshirëse të burimeve financiare të ndara dhe të shpërndara për organizatat joqeveritare, si dhe mënyrën se si këto fonde janë përdorur për të përmbushur misionet dhe aktivitetet e tyre. Vëmendje e veçantë i është kushtuar vlerësimit të rezultateve dhe ndikimit konkret në komunitet, si dhe zhvillimit të mëtejshëm të kapaciteteve institucionale për t'u përballur me sfidat bashkëkohore në një mjedis dinamik dhe kërkuar.

Përmes këtij raporti riafirmojmë angazhimin tonë për llogaridhënie institucionale dhe demonstrojmë kontributin tonë në avancimin e zhvillimit të qëndrueshëm shoqëror dhe ekonomik. Gjithashtu, raporti ofron një pasqyrë të objektivave dhe parashikimeve strategjike për të ardhmen, duke theksuar rëndësinë e bashkëpunimit të vazhdueshëm ndërmjet institucioneve publike dhe organizatave të shoqërisë civile.

Megjithëse sfidat vazhdojnë të jenë të pranishme, mbetemi plotësisht të përkushtuar për t'i adresuar ato me politika dhe strategji të qarta, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme, të cilat shërbejnë interesave afatgjata të qytetarëve tanë.

Faleminderit për mbështetjen dhe bashkëpunimin tuaj të vazhdueshëm në këtë udhëtim të përbashkët drejt shërbimit publik dhe transformimit pozitiv shoqëror.

Me respekt,
Habit Hajredini,
Drejtore, Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit

1. HYRJE

Rregullorja MF-Nr. 04/2017 për Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, përcakton detyrimet e institucioneve publike për raportimin e financimit të projekteve dhe programeve të OJQ-ve, duke synuar unifikimin e të gjithë ciklit të financimit publik – nga planifikimi, thirrjet publike, kontraktimi, monitorimi e deri te raportimi.

Rregullorja ka përcaktuar po ashtu rolin jo vetëm të Zyrës për Qeverisje të Mirë/Zyrës së Kryeministrit por edhe të gjitha institucioneve për procesin e përgatitjes së Raportit gjithëpërfshirës të mbështetjes financiare publike për OJQ-të. Bazuar në Nenin 26 të rregullores, të gjitha organizatat buxhetore duhet ta përgatisin raportin e tyre për vitin paraprak fiskal dhe e përcjellin te ZQM/ZKM. Përveç dërgimit të këtij raporti në Zyrën për Qeverisje të Mirë/Zyrën e Kryeministrit, Organizatat buxhetore duhet të njëjtin raport ta publikojnë në faqen e internetit të institucionit përkatës.

Zyra e Kryeministrit/Zyra për Qeverisje të Mirë është përgjegjëse të përmbledhë dhe të publikoj raportin gjithëpërfshirës të mbështetjes financiare Publike për OJQ-të i cili duhet të përfshijë çdo lloj mbështetje financiare që u është dhënë OJQ-ve gjatë vitit paraprak në të gjitha njësitë organizative të organizatave buxhetore në Republikën e Kosovës.

Zyra për Qeverisje të Mirë (ZQM) në Zyrën e Kryeministrit, në përputhje me këtë rregullore, ka ftuar të gjitha institucionet përkatëse të raportojnë për vitin 2024 në platformën online për financim publik të OJQ-ve <http://ojqfinancime.rks-gov.net>. Kjo platformë ofron të dhëna të detajuara sipas viteve, institucioneve, OJQ-ve, regjioneve dhe sektorëve të përkrahur, duke rritur transparencën dhe llogaridhënien. Për të lehtësuar këtë proces, janë shpërndarë manualët dhe video-udhëzuesit për përdorimin e platformës, si dhe është ofruar përkrahje teknike për të gjithë koordinatorët dhe zyrtarët përgjegjës të institucioneve.

Përmbledhja e raportit për vitin 2024 prezanton para publikut ndarjen e fondeve publike për OJQ-të nga pothuaja gati të gjitha ministritë dhe komunat e Republikës së Kosovës. Pra, janë 15 ministri, Zyra e Kryeministrit me tri zyra dhe Agjencioni për Barazi Gjinore në kuadër të Zyrës së Kryeministrit dhe 38 Komuna që obligohen të raportojnë për financimin publik të OJQ-ve për viti 2024.

Për vitin 2024 janë ZKM me zyrat e saj që kanë raportuar në platformë për ndarjen e fondeve për OJQ-të, ABGJ, janë 15 ministri të linjës që kanë raportuar. Nga këto janë 10 ministri që kanë raportuar direkt në platformë se kanë përkahur OJQ-të dhe 5 prej ministrive që kanë raportuar se gjatë vitit 2024 nuk kanë përkrahur OJQ.

Ndërsa prej 38 komunave të Republikës së Kosovës, janë 23 komuna të cilat kanë raportuar në platformën për financim publik <http://ojqfinancime.rks-gov.net/> se kanë përkrahur OJQ.

Për raportin për fondet publike për OJQ-të janë 12 komuna nga 38 të cilat kanë raportuar se nuk kanë përkrahur OJQ-të dhe 03 tri prej tyre që nuk kanë raportuar. Shumë nga komunat kanë raportuar me vonesë andaj edhe publikimi i raportit nga ana jonë është vonuar duke provuar që të pëfshihen të gjitha të dhënat. Duam të i falënderojmë koordinatorët për korrektësinë dhe përkushtimin në proces të raportimit për financimin publik të OJQ-ve, qoftë përmes platformës për financim publik apo përmes dorëzimit me kohë të formularit F-20 në ZKM/ZQM, veçanërisht ata që janë përballur me vështirësi teknike për qasje në platformën për financim <http://ojqfinancime.rks-gov.net/>.

Gjatë javëve të fundit, janë paraqitur probleme teknike që kanë ndikuar në funksionimin e platformës për financimin publik të OJQ-ve, duke penguar qasjen dhe përdorimin e saj nga institucionet dhe publiku ([shih njoftimin](#)). Për pasojë, nuk kemi pasur mundësi të finalizojmë dhe publikojmë të dhënat e raportuara deri më tani. Këto vonesa kanë qenë jashtë kontrollit tonë dhe për fat të keq të pashmangshme. Zyrën e IT në ZKM, ZQM/ZKM dhe ASHI-në po punojmë ngushtë për zgjidhjen sa më të shpejtë ngecjet në këto çështje teknike. Pra, po ndërmarren masa konkrete për përmirësimin e saj dhe janë angazhuar ekspertiza të reja për ta avancuar më tej funksionalitetin. Pra, vonesat në raportim nga disa komuna kanë ndikuar në vonimin e publikimit të raportit përfundimtar.

ZQM/ZKM ka përgatitë raportin gjithëpërfshirës për vitin 2024, në përputhje me nenin 26 të Rregullores MF-Nr. 04/2017, i cili do të shërbejë si mjet kyç për vlerësimin e ndikimit të financimeve publike dhe për planifikimin e mbështetjes së ardhshme për OJQ-të.

Falënderojmë të gjitha institucionet për bashkëpunimin e deritanishëm dhe i inkurajojmë për përkushtim edhe më të madh gjatë vitit 2025. Suksese të reja dhe më të mëdha na presin përpara, me transparencë, efikasitet dhe bashkëpunim të fuqizuar ndërinstitucional.

1.1 Metodologjia e përdorur

Pra, ashtu si edhe u theksua me lartë Zyra e Kryeministrit /Zyra për Qeverisje të Mirë dhe Ministria e Financave tashmë kanë krijuar një sistem transparent, të qëndrueshëm dhe të përgjegjshëm për financimin e Organizatave të Shoqërisë Civile. Rrjedhimisht transparencën për ndarjen e fondeve publike për OShC-të dhe përgjegjshmërinë e instiucioneve për ndarjen e këtyre fondeve e kemi forcuar më shumë me përditësimin dhe avancimin e Platformës Online për Financim Publik të OJQ-ve <http://ojqfinancime.rks-gov.net/>. Kjo patjetër që po kontribuon në rritjen e besimit të publikut në institucionet publike dhe partneritetin me organizatat e shoqërisë civile. Gjithashtu kjo besojmë se do të frymëzojë qytetarët që të bëhen edhe më aktiv, të jenë pjesë të këtij procesi dhe të kontribuojnë në dobi të komunitetit dhe këtij bashkëpunimi.

Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit në përputhje me kërkesat e Rregullores, MF-Nr. 04/2017, bashkë me zyrtarët përgjegjës për këtë proces që janë caktuar nga secila organizatë buxhetore për Zyrën e Kryeministrit, pra, të gjitha ministritë si dhe pothuajse në të gjitha komunat përgjegjëse, janë pjesë e procesit të finalizimit të këtij raporti.

Të gjitha pikat e kontaktit/koordinatorët po bëjnë tashmë koordinim shumë më të mirë të procesit të planifikimit dhe raportimin vjetor lidhur me fondet publike të alokuara për organizatat joqeveritare nga të gjitha organizatat buxhetore në Republikën e Kosovës.

Platforma e Financimit Publik <https://ojqfinancime.rks-gov.net>, e udhëhequr nga Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit (ZQM/ZKM) në bashkëpunim me njësinë për IT në ZKM dhe Agjencinë për Shoqëri Informativ (ASHI) ka kaluar nëpër një proces të thelluar përmirësimi, funksionalizimi dhe avancimi teknologjik. Përveç bartjes së platformës në një server, tani ajo ofron mundësinë e raportimit hierarkik me shumë përdorues për financimin publik të organizatave të shoqërisë civile (OSHC) nga të

gjitha ministritë, Zyra e Kryeministrit dhe Komunitet e Republikës së Kosovës, përfshirë edhe nën-njësitë e tyre përkatëse.

Në Zyrën për Qeverisje të Mirë/Zyrën e Kryeministrit po angazhohet një ekspert i veçantë për dy vite vetëm për ta administruar, mirmbajtur dhe kontrolluar platformën për financim publik të OJQ-ve. Platforma tashmë mundëson raportimin e financimeve publike përmes një sistemi të dyfishtë të futjes së të dhënave, qoftë përmes raportimit të drejtpërdrejtë të secilit projekt të financuar nga institucionet publike, qoftë përmes raportimit masiv, ku institucionet publike mund të mbledhin të dhëna nga nën-njësitë dhe t'i importojnë ato përmes modulit të posaçëm të importit në platformë.

Në aspektin e qasjes publike, platforma ofron veçori të reja të filtrimit të të dhënave dhe grafikë ndërveprues, të cilët vizualizojnë informacionin dhe i ndihmojnë qytetarët të kuptojnë më mirë se si shpenzohen fondet publike nga secili institucion, cilat OSHC i kanë përfituar ato, në cilat zona gjeografike janë shpenzuar mjetet, si dhe për cilat fusha dhe aktivitete janë përdorur fondet.

Një përmirësim tjetër i rëndësishëm, i realizuar me mbështetjen e projektit TACSO, është lidhja e Platformës së Financimit Publik të OJQ-ve me Platformën e Donatorëve, e cila tashmë i mundëson publikut të ketë qasje edhe në të dhënat për fondet që ndahen nga donatorët për OJQ-të në Republikën e Kosovës (Mënyrë kjo është jashtë funksionit).

Avancimi dhe zhvillimi i mëtejshëm i platformës do të vazhdojë edhe gjatë vitit 2025-2026, në kuadër të reformave të planifikuara. Megjithatë platforma ekzistuese është përmirësuar ndjeshëm, zyrtarët publikë ende kanë nevojë për ngritje të kapaciteteve për zbatimin e rregullores dhe për përdorimin efektiv të platformës në përputhje me sistemin e ri të avancuar. Në këtë fazë të raportimit, është me rëndësi të theksohet se Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT) ka nisur një proces të rishikimit të rregullores aktuale për financimin publik të OJQ-ve, me qëllim të adresimit të pengesave kryesore të identifikuara gjatë viteve të para të zbatimit, si dhe për të lehtësuar punën e zyrtarëve në përputhje me proceset e reja.

Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit gjatë këtij viti ka përdorur të dhënat e dërguara nga organizatat buxhetore që kanë raportuar në platformë dhe nuk ka përdorur të dhëna shtesë nga Departamenti i Thesarit në MFPT, për shkak se pothuajse të gjitha institucionet kanë raportuar në mënyrë të drejtpërdrejtë. Gjithashtu, ZQM/ZKM ka analizuar ueb-faqet e institucioneve publike për të shqyrtuar thirrjet publike, përmbajtjen e tyre dhe rrjedhën e procedurës për financimin e OJQ-ve.

Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit nuk mban përgjegjësi për saktësinë e të dhënave të raportuara nga organizatat buxhetore, përfshirë të dhënat mbi emërtimet e OJQ-ve dhe elementë të tjerë të raportimit.

2. TË DHËNA E PËRGJITHSHME PËR RAPORTIM NGA ANA E ORGANIZATAVE BUXHETORE

2.1 Raportimi nga Organizatat Buxhetore

Rregullorja MF-Nr. 04/2017 për Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, ka vendosur një kuadër të unifikuar për procesin e financimit publik të organizatave të shoqërisë civile në Republikën e Kosovës. Kjo rregullore, përveç që përcakton qartë kriteret dhe procedurat për mbështetjen financiare, përfshin edhe detyrime specifike të institucioneve publike për raportimin e financimit publik të OJQ-ve.

Rregullorja thekson përgjegjësinë e Zyrës për Qeverisje të Mirë në Zyrën e Kryeministrit (ZQM/ZKM) për të përgatitur raportin gjithëpërfshirës për mbështetjen financiare publike për OJQ-të, në bazë të të dhënave të raportuara nga të gjitha institucionet publike. Në këtë kuadër, roli i ZQM/ZKM dhe i vetë institucioneve buxhetore është i qartë dhe i përcaktuar në mënyrë të detajuar. Sipas nenit 26 të Rregullores MF-Nr. 04/2017, të gjitha organizatat buxhetore janë të obliguara të përgatisin raportin vjetor për vitin fiskal paraprak deri më 1 mars të çdo viti dhe ta dërgojnë atë në ZQM/ZKM. Po ashtu, të njëjtat institucione janë të detyruara të publikojnë këtë raport edhe në faqet zyrtare të internetit të institucioneve përkatëse.

ZQM/ZKM është përgjegjëse të mbledhë, përpunojë dhe publikojë raportin gjithëpërfshirës të mbështetjes financiare publike për OJQ-të, duke përfshirë çdo lloj mbështetje financiare të ofruar gjatë vitit paraprak nga të gjitha njësitë organizative të institucioneve publike në nivel qendror dhe lokal.

Digjitalizimi i Raportimit dhe Platforma për Financimin Publik të OJQ-ve - Nga viti 2021, është avancuar dhe funksionalizuar Platforma për Financimin Publik të OJQ-ve: <http://ojqfinancime.rks-gov.net>, e cila mundëson raportimin e drejtpërdrejtë nga të gjitha organizatat buxhetore në përputhje me formatin e përcaktuar në rregullore. Raportimi bëhet në bazë të Manualit për përdorim të platformës, të hartuar nga ZQM/ZKM me mbështetjen e ekspertëve të projektit TACSO.

Zyra për Qeverisje të Mirë ka ofruar materiale udhëzuese dhe video praktike, përfshirë udhëzime për regjistrim në platformë, futjen e të dhënave dhe përdorimin e modulit të importit. Për më tepër, janë krijuar dhe azhurnuar llogaritë e zyrtarëve përgjegjës në nivel ministror dhe komunal për të lehtësuar raportimin dhe për plotësimin e të dhënave në mënyrë efikase.

Përgjegjësitë dhe Ndërlidhja me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike - Në komunikimin me institucionet publike, ZQM/ZKM ka theksuar se mosraportimi apo vonesat në raportim përbëjnë shkelje të dispozitave të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, pasi që Rregullorja MF-Nr. 04/2017 është bazuar në këtë ligj. Prandaj, raportimi i plotë dhe në kohë i financimeve publike për OJQ-të është një detyrim ligjor dhe institucional. ZQM/ZKM ka shfaqur gatishmëri të plotë për të ofruar asistencë dhe mbështetje për të gjitha organizatat buxhetore që kanë nevojë për ndihmë në përgatitjen e raporteve vjetore, njësoj si në vitet e kaluara.

Përmirësimet dhe Sfidat në Raportim - Përkundër përmirësimeve të dukshme në raportim krahasuar me vitet e kaluara, të dhënat tregojnë se ende një numër i konsiderueshëm i institucioneve publike ka nevojë për ngritje të kapaciteteve në mënyrë që raportet e tyre të jenë në përputhje me kërkesat e rregullores, standardet dhe afatet e përcaktuara.

Pjesëmarrja e Institucioneve në Raportimin për Vitin 2024 - Pjesë e përfshirjes në këtë raport janë 54 institucione/organizata buxhetore qeveritare prej të cilave (ZKM ka katër zyra në kuadër të saj: Agjencioni për Barazi Gjinore, Zyra për Kthim e Komunitete, Komisioneri për Gjuhët dhe Komisioni Qeveritar për Persona të Zhdukur), 15 (pesëmbëdhjete) Ministri dhe 38 (tridhjetë e tetë) Komuna.

Figura në vijim paraqet përqindjen dhe numrin e institucioneve që kanë raportuar në përputhje me Rregulloren MF-Nr. 04/2017, si dhe ato që nuk kanë dorëzuar raportin apo nuk i kanë përmbushur kërkesat e përcaktuara.

Nga figura më poshtë shihet se nga gjithsej 54 institucione/organizata buxhetore janë:

- 51 institucione/organizata buxhetore ose.. % që kanë raportuar
- 03 institucione/organizata buxhetore ose... %, që nuk kanë raportuar.
- Prej 51 sa kanë raportuar janë 05 ministri dhe 12 komuna ose .. % që kanë raportuar se nuk kanë përkrahur OJQ dhe 03 komuna që nuk ka raportuar.




Figura 1. Të dhënat e përgjithshme sa i përket raportimit nga institucionet/organizatat buxhetore për vitin 2023

Sa i përket nivelit qendror, nga figura më poshtë janë nxjerrë të dhënat për ZKM dhe ministrinë ku shihet se nga gjithsej 16 organizata buxhetore janë:

- 11 organizata buxhetore ose % kanë raportuar se kanë përkrahur OJQ dhe
- 05 organizata buxhetore ose % kanë raportuar se nuk kanë përkrahur OJQ.




Figura 2. Të dhënat e përgjithshme sa i përket raportimit nga niveli qendror për vitin 2024

Ndërsa nga figura në vijm janë paraqitur të dhënat për nivelin lokal se si i janë përgjigjur kërkesës së ZQM/ZKM për të raportuar për finacimin publik të OJQ-ve. Pra, nga figura më poshtë janë nxjerrë të dhënat për nivelin lokal ku shihet se nga gjithsej 38 organizata buxhetore:

- 23 komuna/organizata buxhetore ose.. % që kanë raportuar në platformë se kanë përkrahur OJQ
- 12 komuna/organziata buxhetore ose % që kanë raportuar se nuk kanë përkrahur OJQ dhe
- 03 komuna/organizata buxhetore ose % që nuk kanë raportuar.




Figura 3. Të dhënat e përgjithshme sa i përket raportimit nga niveli lokal për vitin 2024

2.2 Të dhëna mbi financim publik të OJQ-ve të raportuara sipas institucioneve/organizatave buxhetore për vitin 2024

Në tabelën në vijim janë paraqitur të dhënat sa i përket raportimit sipas secilit institucion/organizatës buxhetore të cilës i është kërkuar të raportoj ose ka pasur financim për OJQ-të në vitin 2024. Disa nga institucionet, kanë theksuar se nuk kanë financuar projekte të OJQ-ve ose nuk kanë shpallur thirrje publike.

Tabela 1: Të dhënat për financimin publik të OJQ-ve sipas raporteve të përcjella/raportuara nga ana e Institucioneve gjatë vitit 2024 direkt në platformë, ato që kanë raportuar se nuk kanë ndarë fonde dhe ato që nuk kanë raportuar fare janë në tabelën në vijim:

NR.	EMRI I ORGANIZATËS BUXHETORE	RAPORTIMI NË ZQM BAZUAR NË RREGULLOREN MF-04/2017
ZYRA E KRYEMINISTRIT		
	ZYRA E KRYEMINISTRIT	1. Agjencia për Barazi Gjinore kanë raportuar se gjatë vitit 2024 kanë përkrahur organizata joqeveritare dhe kanë raportuar direkt në platformë 2. Zyra e Komisionerit për Gjuhët, kanë raportuar në platformë dhe kanë raportuar se gjatë vitit 2024 kanë përkrahur organizata joqeveritare

		3. Zyra për Komunitete kanë raportuar direkt në platformë/kanë raportuar se gjatë vitit 2024 kanë përkrahur organizata joqeveritare 4. Zyra e Komisionerit për Persona të Pagjetur kanë raportuar se gjatë vitit 2024 nuk kanë përkrahur organizata joqeveritare.
MINISTRITË E LINJËS		
1.	MINISTRIA E ADMINISTRIMIT TË PUSHTETIT LOKAL	MAPL kanë raportuar direkt në platformë/gjatë vitit 2024 kanë përkrahur organizata joqeveritare
2.	MINISTRIA E ARSIMIT SHKENCËS TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT	MASHTI kanë raportuar direkt në platformë/gjatë vitit 2024 kanë përkrahur organizata joqeveritare
3.	MINISTRIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL	MBPZHR kanë raportuar direkt në platformë/gjatë vitit 2024 kanë përkrahur organizata joqeveritare
4.	MINISTRIA E DREJTËSISË	MD kanë raportuar direkt në platformë/ gjatë vitit 2024 kanë përkrahur organizata joqeveritare
5.	MINISTRIA E FINANCAVE PUNËS DHE TRANSFEREVE	MFPT kanë raportuar se gjatë vitit 2024 nuk kanë përkrahur organizata joqeveritare
6.	MINISTRIA E MBROJTJES	MM kanë raportuar se gjatë vitit 2024 nuk kanë përkrahur organizata joqeveritare
7.	MINISTRIA MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPSIONR DHE INFRASTRUKTURËS	MMPHI kanë raportuar se nuk kanë përkrahur organizata joqeveritare
8.	MINISTRIA E KULTURËS RINISË DHE SPORTIT	MKRS kanë raportuar direkt në platformë/ gjatë vitit 2024 kanë përkrahur organizata joqeveritare
9.	MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME	MPB kanë raportuar se gjatë vitit 2024 nuk kanë përkrahur organizata joqeveritare
10.	MINISTRIA E PUNËVE TË JASHTME DHE DIASPORËS	MPJD kanë raportuar direkt në platformë/ gjatë vitit 2024 kanë përkrahur organizata joqeveritare
11.	MINISTRIA E SHËNDETËSISË	MSH kanë raportuar direkt në platformë/ gjatë vitit 2024 kanë përkrahur organizata joqeveritare
12.	MINISTRIA E EKONOMISË	ME kanë raportuar direkt në platformë/ gjatë vitit 2024 kanë përkrahur organizata joqeveritare
13.	MINISTRIA E ZHVILLIMIT RAJONAL	MZHR kanë raportuar direkt në platformë/ gjatë vitit 2024 kanë përkrahur organizata joqeveritare
14.	MINISTRIA PËR KOMUNITETE DHE KTHIM	MKK kanë raportuar direkt në platformë/ gjatë vitit 2024 kanë përkrahur organizata joqeveritare
15.	MINISTRIA E INDUSTRIËS, NDËRMARRËSISË DHE TREGTISË	MINT kanë raportuar se nuk ka pasur financim të OJQ-ve gjatë vitit 2024

N R .	EMRI I ORGANIZATËS BUXHETORE	RAPORTIMI NË ZQM BAZUAR NË RREGULLOREN MF-04/2017
KOMUNAT		
1.	KOMUNA E DEÇANIT	Komuna e Deçanit kanë raportuar direkt në platformë/ gjatë vitit 2024 kanë përkrahur organizata joqeveritare
2.	KOMUNA E DRAGASHIT	Komuna e Dragashit kanë raportuar direkt në platformë/ gjatë vitit 2024 kanë përkrahur organizata joqeveritare

3.	KOMUNA E FERIZAJIT	Komuna e Ferizajt kanë raportuar direkt në platformë/ gjatë vitit 2024 kanë përkrahur organizata joqeveritare
4.	KOMUNA E FUSHË KOSOVËS	Komuna e Fushë Kosovës kanë raportuar direkt në platformë/ gjatë vitit 2024 kanë përkrahur organizata joqeveritare
5.	KOMUNA E GJAKOVËS	Komuna e Gjakovës kanë raportuar direkt në platformë/ gjatë vitit 2024 kanë përkrahur organizata joqeveritare
6.	KOMUNA E GJILANIT	Komuna e Gjilanit kanë raportuar direkt në platformë/ gjatë vitit 2024 kanë përkrahur organizata joqeveritare
7.	KOMUNA E DRENASIT(GLLOGOCIT)	Komuna e Drenasit kanë raportuar direkt në platformë/ gjatë vitit 2024 kanë përkrahur organizata joqeveritare
8.	KOMUNA E GRAÇANICËS	Komuna e Graçanicës kanë raportuar direkt në platformë/ gjatë vitit 2024 kanë përkrahur organizata joqeveritare
9.	KOMUNA E HANIT TË ELEZIT	Komuna e Hanit të Elezit kanë raportuar direkt në platformë/ gjatë vitit 2024 kanë përkrahur organizata joqeveritare
10.	KOMUNA E ISTOGUT	Komuna e Istogut kanë raportuar direkt në platformë/ gjatë vitit 2024 kanë përkrahur organizata joqeveritare
11.	KOMUNA E JUNIKUT	Komuna e Junikut kanë raportuar direkt në platformë/ gjatë vitit 2024 kanë përkrahur organizata joqeveritare
12.	KOMUNA E KAÇANIKUT	Komuna e Kaçanikut kanë raportuar direkt në platformë/ gjatë vitit 2024 kanë përkrahur organizata joqeveritare
13.	KOMUNA E KAMENICËS	Komuna e Kamenicës kanë raportuar në F20/ gjatë vitit 2024 kanë përkrahur organizata joqeveritare
14.	KOMUNA E KLINËS	Komuna e Klinës nuk kanë raportuar
15.	KOMUNA E KLLOKOTIT	Komuna e Kllokotit kanë raportuar se nuk ka pasur financim të OJQ-ve gjatë vitit 2024
16.	KOMUNA E LEPOSAVIQIT	Komuna e Leposaviqit nuk kanë raportuar
17.	KOMUNA E LIPJANIT	Komuna e Lipjanit kanë raportuar direkt në platformë/ gjatë vitit 2024 kanë përkrahur organizata joqeveritare
18.	KOMUNA E MALISHEVËS	Komuna e Malishevës kanë raportuar se nuk ka pasur financim të OJQ-ve gjatë vitit 2024
19.	KOMUNA E MAMUSHËS	Komuna e Mamushës kanë raportuar se nuk ka pasur financim të OJQ-ve gjatë vitit 2024
20.	KOMUNA E MITROVICËS SË VERIUT	Komuna e Mitrovicës Veriore kanë raportuar nuk ka pasur financim të OJQ-ve gjatë vitit 2024
21.	KOMUNA E MITROVICËS SË JUGUT	Komuna e Mitrovicës nuk ka raportuar
22.	KOMUNA E NOVO BËRDËS	Komuna e Novo Bërdës kanë raportuar direkt në platformë/ gjatë vitit 2024 kanë përkrahur organizata joqeveritare
23.	KOMUNA E OBILIQIT	Komuna e Obiliqit kanë raportuar direkt në platformë/ gjatë vitit 2024 kanë përkrahur organizata joqeveritare
24.	KOMUNA E PARTESHIT	Komuna e Parteshit kanë raportuar direkt në platformë/ gjatë vitit 2024 kanë përkrahur organizata joqeveritare
25.	KOMUNA E PEJËS	Komuna e Pejës kanë raportuar direkt në platformë/ gjatë vitit 2024 kanë përkrahur organizata joqeveritare
26.	KOMUNA E BESIANËS/ PODUJEVES	Komuna e Podujevës kanë raportuar direkt në platformë/ gjatë vitit 2024 kanë përkrahur organizata joqeveritare

27.	KOMUNA E PRISHTINËS	Komuna e Prishtinës kanë raportuar direkt në platformë/ gjatë vitit 2024 kanë përkrahur organizata joqeveritare
28.	KOMUNA E PRIZRENIT	Komuna e Prizrenit kanë raportuar direkt në platformë/ gjatë vitit 2024 kanë përkrahur organizata joqeveritare
29.	KOMUNA E RAHOVECIT	Komuna e Rahovecit kanë raportuar direkt në platformë/ Thirrja gjatë vitit 2024 është anuluar dhe ndërprerë para Skadimit të kontratës/ nuk kanë përkrahur organizata joqeveritare
30.	KOMUNA E RANILLUGUT	Komuna e Ranillugut kanë raportuar direkt në platformë/ Thirrja gjatë vitit 2024 është anuluar dhe ndërprerë para Skadimit të kontratës/ nuk kanë përkrahur organizata joqeveritare
31.	KOMUNA E SHTËRPECËS	Komuna Shtërpçës kanë raportuar direkt në platformë/ Thirrja gjatë vitit 2024 është anuluar dhe ndërprerë para Skadimit të kontratës/ nuk kanë përkrahur organizata joqeveritare
32.	KOMUNA E SHTIMES	Komuna e Shtimes kanë raportuar direkt në platformë/ gjatë vitit 2024 kanë përkrahur organizata joqeveritare
33.	KOMUNA E SKENDERAJT	Komuna e Skenderajt kanë raportuar direkt në platformë/ gjatë vitit 2024 kanë përkrahur organizata joqeveritare
34.	KOMUNA E THERANDËS /SUHAREKËS	Komuna e Therandës/Suharekës kanë raportuar direkt në platformë/ Thirrja gjatë vitit 2024 është anuluar dhe ndërprerë para Skadimit të kontratës/ nuk kanë përkrahur organizata joqeveritare
35.	KOMUNA E VITISË	Komuna e Vitisë kanë raportuar direkt në platformë/ Thirrja gjatë vitit 2024 është anuluar dhe ndërprerë para Skadimit të kontratës/ nuk kanë përkrahur organizata joqeveritare
36.	KOMUNA E VUSHTRRIË	Komuna e Vushtrrisë kanë raportuar direkt në platformë/ Thirrja gjatë vitit 2024 është anuluar dhe ndërprerë para Skadimit të kontratës/ nuk kanë përkrahur organizata joqeveritare
37.	KOMUNA E ZUBIN POTOKUT	Komuna e Zubin Potokut kanë raportuar direkt në platformë/ Thirrja gjatë vitit 2024 është anuluar dhe ndërprerë para Skadimit të kontratës/ nuk kanë përkrahur organizata joqeveritare
38.	KOMUNA E ZVEÇANIT	Komuna e Zveçanit kanë raportuar direkt në platformë/Thirrja gjatë vitit 2024 është anuluar dhe ndërprerë para Skadimit të kontratës/ nuk kanë përkrahur organizata joqeveritare

3. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR MBËSHTETJEN FINANCIARE PUBLIKE PËR OJQ-TË NË NIVEL TË MINISTRIVE, KOMUNAVE DHE ZYRËS SË KRYEMINISTRIT PËR 2024

Institucionet e nivelit qendror dhe lokal edhe gjatë vitit 2024 kanë vazhduar mbështetjen e projekteve dhe aktiviteteve të Organizatave jo-qeveritare duke përfshirë financimin e projekteve specifike apo përkrahjes direkte për OJQ-të. Pra, nga ky raport dhe këto të dhëna të mbledhura e të përpunuara mbi financimin publik të OJQ-ve për vitin 2024, mund të konstatojmë se bashkëpunimi me organizatat jo qeveritare në realizimin e prioritetëve të qeverisë në fusha të ndryshme ka vazhduar edhe gjatë vitit 2024.

Nga analiza e të dhënave të dorëzuara nga vetë institucionet dhe të dhënave nga platforma për financim <http://ojqfinancime.rks-gov.net> për vitin 2024 rezulton se mbështetja financiare publike për OJQ-të nga institucionet publike përfshirë nivelin qendror është 706 organizata joqeveritare me

8,357,356.00€ dhe lokal 968 organizata joqeveritare me 5,917,231.97€. Bazuar te pasqyra në platformën për financim publik të OJQ-ve janë 14,274,587.97€ që janë ndarë nga institucionet për OJQ-të. Përgjithësisht janë ...% e shumës së përgjithëshme janë ndarë nga niveli qendror ndërsa € ose % janë ndarë nga niveli lokal.




Figura 4. Të dhëna të përgjithshme për financimin publik të OJQ-ve sipas raporteve të marra nga institucionet/organizatat buxhetore për 2024

Nga të dhënat si më poshtë mund të shihet përafërsisht cilat fusha kanë marrë më së shumti fonde ose janë përkrahur nga ana e institucioneve të nivelit qendror nga ZKM dhe Ministritë e të cilat janë: shërbime sociale 12.69%; arti dhe kultura 40.57%; arsim, shkencë dhe hulumtim 5.34 %; shëndeti 1.50%, e pacaktuar dhe fusha tjera 33.39%.

Fushat e financimit të projekteve të OJQ-ve nga ZKM dhe Ministritë për vitin 2023




Figura 5. Fushat e financimit të Projekteve të OJQ-ve nga ZKM/Ministritë për vitin 2024 në % përqindje të përafërt të financimit sipas të dhënave nga platforma për financim

Ndërsa në figurën më poshtë pasqyrohen fushat e financimit të Projekteve të OJQ-ve nga Komunitet për vitin 2024 në % përqindje të përafërt të financimit, gjithmonë sipas të dhënave dhe raportimit të komunave te platforma për financim.

Në figurën më poshtë nga ana e nivelit lokal fushat që janë përkrahur janë: sporti 24.86 % e fondeve; shërbime sociale 5.08 %; arti dhe kultura 23 %; shëndeti 1.67 %; arsim, shkencë dhe hulumtim 3.10%, e pacaktuar dhe fusha tjera 41.94 %.

Fushat e financimit të projekteve nga komunat në % të përafërt për vitin 2023




Figura 6. Fushat e financimit të Projekteve të OJQ-ve nga Komunat për vitin 2023 në % përqindje të përafërt të financimit sipas te dhënave nga paltforma për financim

Në figurën më poshtë janë paraqitur dhe pasqyruar të dhënat e përafërta për financimin publik të OJQ-ve për vitin 2024 sipas platformës dhe raportimit instiucional për ZKM/ Ministritë /Komunat e jo nga Donatorët Ndërkombëtar (sepse këtë vit ka qenë jo funksionale).

Totali i shumës së fondeve të ndara për OSHC-të nga ZKM /Ministritë/Komunat është € 14,274,587.97 Nga e gjitha kjo shumë Zyra e Kryeministrit dhe Ministritë kanë ndarë 8,357,356.00 € ndërsa Komunat kanë ndarë 5,917,231.97 €.




Figura 7. Të dhënat mbi financimin publik të OJQ-ve për vitin 2023 sipas platformës për ZKM/Ministritë/Komunat dhe DonatorëtNdërkombëtar

Të dhënat për numrin e projekteve të finanacuara për OJQ-të për vitin 2024 sipas platformës online nga ZKM/Ministritë si dhe për Komunat janë paraqitur në figurën më poshtë. Totali i numri të projekteve të OJQ-vë që janë përkrahur gjatë vitit 2024 nga ZKM/Ministritë dhe Komunat është 1724 projekte për OJQ-të. Nga ky numër të dhënat për numrin e projekteve të OJQ-ve nga ZKM/Ministritë janë 706 projekte, ndërsa nga ana e Komunave për vitin 2024 janë financuar 968 projekte.




Fig 8. Të dhënat për numrin e projekteve që janë ndarë për OJQ-ve nga ZKM/Ministritë për vitin 2024




Fig 9. Të dhënat për numrin e projekteve që janë ndarë për OJQ-ve nga ZKM dhe secila Ministri për vitin 2024

Pra, për vitin 2024 nga ana e Komunave të Republikën e Kosovës janë financuar 968 projekte të OJQ-ve. Në figurën më poshtë janë paraqitur të dhënat për numrin e projekteve që janë ndarë për OJQ-ve nga Komunitat për vitin 2024.




Fig 10. Të dhënat për numrin e projekteve që janë ndarë për OJQ-ve nga Komunitat për vitin 2024

Në figurën më poshtë janë paraqitur të dhënat krahasuese për financimin publik të OJQ-ve për vitet 2024 dhe 2023, pra janë krahasuar të dhënat e raportuara nga institucionet publike për numrin e projekteve të financuara sipas platformës online për ZKM/Ministritë si dhe për Komunitat.




Figura 11. Të dhënat krahasuese për financimin publik të OJQ-ve për vitet 2024 dhe 2023 për ZKM/Ministritë dhe Komunat sipas platformës për financim

Nga të dhënat krahasuese për numrin e përfituesve (OJQ-ve) nga ZKM/Ministritë dhe Komunat për vitin 2023 dhe 2024 , pra janë krahasur të dhënat e raportuara nga institucionet publike gjithmonë sipas platformës online për ZKM/Ministritë si dhe për Komunat.

Në nivel ministrive gjatë vititi 2024 vërehet ngritje e konsiderueshme e përkrahjes për numër të OJQ-ve ndërsa në nivel komunash vërehet ulje e përkrahjes së numrit të projekteve përfituesve. Në nivel të ministrive përderisa gjatë vititi 2023 numri i projekteve ka qenë 555 në vitin 2024 është 706, ndërsa në nivel të Komunave përderisa në vitin 2023 ka qenë 1297, në vitin 2024 është 968 projekte. Totali për numër të përfituesve për projekte nga OJQ-të është në vitin 2023 është 1852 projekte të OJQ-ve ndërsa në vitin 2024 është 1674 projekte që janë ndarë dhe janë raportuar.

Qëllimi i mbështetjes financiare të ofruar nga Zyra e Kryeministrit, Ministritë dhe Komunat

Mbështetja financiare publike për organizatat joqeveritare ka për qëllim fuqizimin dhe përkrahjen e tyre për të kontribuar në zhvillimin demokratik, social, ekonomik, kulturor dhe mjedisor të vendit. Kjo mbështetje synon të nxisë zbatimin e projekteve me ndikim në komunitet, rritjen e pjesëmarrjes qytetare dhe transparencës, ofimin e shërbimeve publike në fusha me interes të përgjithshëm dhe zhvillimin e kapaciteteve të OJQ-ve dhe bashkëpunimin ndërinstitutional.

Platforma dhe mekanizmi i raportimit janë zhvilluar për të siguruar ndarjen transparente dhe të barabartë të fondeve publike, në përputhje me prioritetet institucionale dhe nevojat e shoqërisë. Pra, Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit në përputhje me kërkesat e Rregullores, MF-Nr. 04/2017, mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, dhe për zbatim sa më efektiv të kësaj rregulloreje ka themeluar një mekanizmi të përhershëm i cili po koordinon punën e planifikimit dhe raportimit vjetor për financimin e organizatave jo-qeveritare në kuadër të secilës ministri dhe komunë. Raporti përfshin të dhëna mbi mbështetjen financiare publike për OJQ-të nga Qeveria e Republikës së Kosovës, përkatësisht ministritë dhe komunat, për projekte në fusha të ndryshme që lidhen me prioritetet institucionale dhe shoqërore. Të gjitha organizatat buxhetore në nivel qendror dhe lokal që kanë ofruar mbështetje financiare për OJQ-të janë përfshirë.

Avancimi i Procesit të Raportimit

Procesi i raportimit është përmirësuar përmes:

- Hartimit dhe miratimit të Rregullores MF Nr. 04/2017;
- Krijimit të platformës online për financimin e OJQ-ve: <http://ojqfinancime.rks-gov.net>;
- Mundësisë së raportimit të drejtpërdrejtë nga institucionet përmes platformës.

Shumica e institucioneve kanë raportuar përmes platformës. Megjithatë, janë evidentuar raportime të paplota dhe lëshime teknike. Përkundër kësaj, progresi në cilësinë dhe përmbajtjen e të dhënave është i dukshëm.

Raportimi sipas Rregullores MF Nr. 04/2017

Institucionet duhet të raportojnë deri më 1 mars, ndërsa Zyra për Qeverisje të Mirë përgatit raportin gjithëpërfshirës deri më 31 mars. Raporti përfshin:

- Emrin e institucionit mbështetës dhe programin përkatës;
- Metodën e ndarjes së fondeve (thirrje publike/kontratim i drejtpërdrejtë);
- Detaje për përfituesit (OJQ-të), projektin, shumën, kohëzgjatjen, përfituesit, aktivitetet, dhe të dhëna gjeografike.

Raportimi bëhet përmes formularit standard F20, si pjesë përbërëse e rregullores, manualit dhe platformës.

Gjatë gjithë kohës Zyra për Qeverisje të Mirë ka bërë mbështetjen për Institucionet, ka menaxhuar krijimin dhe mirëmbajtjen e llogarive në platformë për zyrtarët përgjegjës si dhe ka zhvilluar sesione informuese për koordinatorët e raportimit nga ministritë dhe komunat.

Gjithmonë në këtë proces ka rekomandime për përmirsim dhe zhvillim.

- Rritja e cilësisë së raportimit – sigurimi që të gjitha institucionet të dorëzojnë raportime të plota, brenda afateve dhe në përputhje me planifikimet vjetore.

- Trajtime të vazhdueshme – veçanërisht për zyrtarët e rinj ose ata që kanë vështirësi teknike.
- Mbikëqyrje dhe verifikim – forcimi i kontrollit të brendshëm për të siguruar përputhshmërinë me Rregulloren MF Nr. 04/2017.
- Përmirësim i platformës – duke adresuar pengesat teknike dhe duke shtuar funksionalitete për raportim më të detajuar dhe transparent.
- Koordinim i ngushtë ndërinstitucional – për një zbatim më efektiv dhe uniform të standardeve të raportimit.

Sipas rregullores, këto raporte do të duhej të përfshijnë ndër të tjera:

- ✓ Emrin e ofruesit të mbështetjes financiare publike (Ministritë, komunës, agjencisë duke përfshirë programet specifike në kuadër të të cilave ofrohet mbështetja financiare publike);
- ✓ Mënyrën e alokimit të mbështetjes financiare publike (përmes thirrjes/kontraktim direkt);
- ✓ Thirrjen publike përmes të cilës është ofruar mbështetja financiare;
- ✓ Emrin e plotë të përfituesve të mbështetjes financiare (duke përfshirë edhe të dhënat tjera të përfituesit, adresën, numrin e regjistrimit dhe numrin fiskal dhe të dhënat për personin përgjegjës të OJQ-së;
- ✓ Emërtimin e projektit/programit apo aktiviteteve të financuara;
- ✓ Shumën e dhënë për financimin e projektit/programit;
- ✓ Kohëzgjatjen e projektit dhe statusin e zbatimit të tij;
- ✓ Fushat e përgjithshme dhe specifike të financimit;
- ✓ Përfituesit e drejtpërdrejtë dhe të tërthortë;
- ✓ Aktivitetet apo shërbimet kryesore të realizuara në kuadër të projektit;
- ✓ Të dhënat gjeografike sa i përket vendit të implementimit të projektit;
- ✓ Numrin e personave që kanë përfituar apo janë punësuar në kuadër të projektit/programit.

Zyrtarët përgjegjës (koordinatorët) për këtë proces janë caktuar nga të gjitha ministritë, nga Zyra e Kryeministrit, si dhe nga 38 komunat përgjegjëse.

Përfitimet institucionale nga përkrahja e financimit publik të OJQ-ve

Vlerësojmë se jo vetëm qytetarët por edhe ministritë dhe komunat përfitojnë nga ky financim në mënyra të ndryshme dhe shumë të vleshme për neve si institucione publike dhe punën tonë të përditëshme. Duam të veçojmë përfitimet tona si institucione në këtë përkrahje:

- Ndihma për zbatimin e politikave publike: financimi i organizatave joqeveritare mund dhe po përdoret për të mbështetur zbatimin e politikave dhe strategjive të qeverisë në fusha të ndryshme si arsim, shëndetësi, zhvillim ekonomik dhe mbrojtje të mjedisit.
- Ndërtimi i kapaciteteve të shërbyesve civil: organizatat joqeveritare mund dhe po ofrojnë trajnime dhe asistencë teknike për zbatimin e politikave dhe për të ndihmuar në forcimin e kapaciteteve të personelit të ministrive dhe komunave për të përmbushur qëllimet e tyre.

- Monitorimi dhe vlerësimi i politikave: përmes financimit të organizatave joqeveritare, ministritë dhe komunat mund dhe po sigurojnë monitorimin dhe vlerësimin më të qëndrueshëm të efikasitetit dhe impaktit të politikave dhe programeve të tyre.
- Përfaqësimi dhe konsultimi publik i komunitetit: organizatat joqeveritare kanë një lidhje të ngushtë me komunitetin e mund dhe po shërbejnë si zëdhënës instiucional në proceset e politikëbërësve dhe të vendimmarrjes, duke përmirësuar transparencën dhe pjesëmarrjen në bërjen e këtyre politikave.
- Inovacion dhe eksperimentim: financimi i organizatave joqeveritare mund dhe duhet të lejojë ministritë dhe komunat të eksperimentojnë me modele të reja të shërbimeve dhe programeve që të ofrojnë zgjidhje inovative për sfidat tona të përbashkëta.

4. TË DHËNA PËR MBËSHTETJEN FINANCIARE PUBLIKE PËR OJQ-TË SIPAS ZKM, MINISTRIVE DHE KOMUNAVE

4.1 Të dhënat e përgjithshme për financimin publik të OJQ-ve për vitin 2024 sipas raportimit nga ZKM, Ministrinë dhe Komunat

Tabela në vijim pasqyron raportet/të dhënat sipas Zyrës së Kryeminsitrit, Ministrive të Linjës dhe Komunave të Republikës së Kosovës, pra pasqyrohen shuma e pagesave që janë kryer gjatë vitit fiskal 2024 duke filluar nga 01 - 31 janar. Pra, këto të dhëna ndërlidhen me raportimet e institucioneve/organizatave buxhetore dhe përfshijnë shume e dhëna nga secila prej tyre e të publikuara te platforma ose përcjella drejt në ZQM/ZKM.

